




REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

## Vizitë pune e Ministres së Drejtësisë Znj. Etilda Gjonaj në qarkun e Vlorës

2018-02-21 13:10:00



Ministrja e Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj në kuadër të takimeve me bazë qarku dhe platformës së bashkëqeverisjes me qytetarët e zakonshëm, zhvilloi më datë 20 Shkurt 2018 vizita pune në institucionet e varësisë të qarkut Vlorë. Gjatë kësaj vizite Znj. Gjonaj si fillim u prit në Bashkinë e Vlorës nga Kryetari z. Dritan Leli dhe Prefekti i Qarkut Vlorë z. Flamur Mamaj, në të cilën theksoi bashkëpunimin e mirë midis pushtetit vendor dhe qendror për zgjidhjen e problematikave të ndryshme.

Më tej, Ministrja e Drejtësisë shoqëruar nga Prefekti i Qarkut, Kryetari i Bashkisë si dhe Drejtorët e Përgjithshëm të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë vizitoi zyrat vendore të këtyre institucioneve.

Vizitën e parë Znj. Gjonaj e zhvilloi në ZVRPP Vlorë, ku u takua me qytetarët e pranishëm pranë sporteleve të pritjes së popullit të këtij institucioni për t'u njohur nga afër me problematikën e qytetarëve në lidhje me procesin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Ministrja Gjonaj në fjalën e saj gjatë takimit me drejtuesin dhe stafin e këtij institucioni kërkoi trajtimin e të gjitha ankesave të qytetarëve brenda afatit kohor 10 ditor, duke insistuar në mos zvarritjen apo sorollatjen e qytetarëve për dhënien e përgjigjeve në kohë për aplikimet e paraqitura.

Znj. Gjonaj në një prononcim për median u bëri thirrje qytetarëve që të denoncojnë rastet korruptive në portalin shqipëriaqeduam.al. Qeveria shqiptare, theksoi znj. Gjonaj, po ndërmerr një reformë të madhe për çështjen e pronave, duke i trajtuar në mënyrë të integruar të gjithë titujt e pronësisë përmes një Agjencie.

Në takimin në zyrën e ALUIZNI-t në Vlorë, Ministrja Gjonaj kërkoi nga ky institucion që të përfundohen sa më shpejtë të gjitha legalizimet të cilat janë në proces konform kriterëve ligjore. Nga ana tjetër prioritare është kryerja e procesit të legalizimeve duke përcaktuar zonat në bllok dhe jo në mënyrë selektive. Shërbimi ndaj qytetarit duhet të përbëjë një prioritet kryesor edhe në këtë institucion me qëllim dhënien e një shërbimi të merituar dhe të shpejtë brenda afateve ligjore.

Në takimet e zhvilluara në IEVP-në e Vlorës, Ministrja e Drejtësisë vuri theksin në reformën e ndërmarrë me nisjen e procesit të vettingut për policinë e burgjeve, duke theksuar se "punonjësit e rinj do të rekrutohen pranë strukturave vetëm pas testimave dhe trajnimeve nga Akademia e Sigurisë". Nga ana tjetër Znj. Gjonaj theksoi se së shpejti do të nisë edhe trajnimi i punonjësve aktual në sistemin penitenciar në mënyrë që çdo punonjës në këto institucione të përmbushë kriteret prioritare sa i përket profesionalizmit, integritetit apo verifikimit të gjendjes gjyqësore.

Gjatë vizitës në Vlorë, në kuadër të platformës së bashkëqeverisjes me qytetarët znj. Gjonaj zhvilloi gjithashtu një dëgjese publike me komunitetin mbi problematikën në sektorin e drejtësisë në këtë qark. Gjatë bashkëbisedimit, Ministrja e Drejtësisë vlerësoi si tepër të rëndësishme procesin e Reformës në Drejtësi, si më e madhja e ndërmarrë në këto 27 vite duke theksuar se jemi në fazën e marrjes së rezultateve të para nga procesi i Vettingut. Në kuadër të

jetësimi të kësaj reforme znj. Gjonaj shprehu edhe njëherë mbështetjen e plotë buxhetore dhe infrastrukturore të qeverisë shqiptare për ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja të drejtësisë. Së bashku me qytetarët u trajtuan një sërë shqetësimesh dhe problematikash kryesisht lidhur me procesin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të cilat znj. Gjonaj premtoi që do të ndiqen nga ana e Ministrisë me qëllim që qytetari të marrë përgjigje apo zgjidhje në bazë të kërkesë së paraqitur prej tij.

Ministrja e Drejtësisë ftoi të gjithë qytetarët që ankesat e tyre t'i adresojnë në portalin [shqipëriaqeduam.al](http://shqipëriaqeduam.al) me premtimin që çdo ankese në këtë portal shkon në tryezë të Ministrit dhe stafit të tij të cilët angazhohen maksimalisht për zgjidhjen dhe trajtimin e ankesave të qytetarëve brenda një kohe jo më vonë se 10 ditë.

Në përfundim të këtij takimi, Ministrja vlerësoi praninë e Prefektit të Vlorës z. Flamur Mamaj, kryebashkiakut z. Dritan Leli, kryebashkiakut të Himarës, z. Jorgo Goro, si dhe të deputetëve të qarkut Vlorë duke falenderuar gjithë qytetarët e pranishëm dhe ata të cilët bënë publike problematikat apo shqetësimet e tyre.